

LEONARD PERJAKU

Drejt看 i Administratës së Zonave të Mbrojtura Lezhë (ADZM Lezhë).

Z. Leonard Perjaku ushtron detyrën e Drejtorit të Administratës Rajonale të Zonave të Mbrojtura Lezhë që prej marsit 2026.

Me formim në fushën e drejtësisë, z. Perjaku është diplomuar në vitin 2009 pranë Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, me titullin “Jurist”. Karrierën profesionale e ka nisur në vitin 2010 si Jurist dhe Përgjegjës i Zyrës Juridike pranë ish-Komunës Kolsh, Lezhë.

Në vitin 2014 ka fituar titullin “Avokat” dhe deri në vitin 2018 ka ushtruar profesionin e avokatit, me përvojë në çështje penale, civile, administrative dhe familjare.

Gjatë periudhës 2018–2023 ka shërbyer si Drejt看 i Degës Territoriale të Shërbimit të Provës Lezhë, ndërsa në vitin 2023 ka ushtruar detyrën e Administratorit të Njësisë Administrative Zejmen pranë Bashkisë Lezhë.

Z. Perjaku sjell një eksperiencë të konsoliduar në qeverisjen vendore, sistemin e drejtësisë dhe administrimin publik, ndërsa në detyrën aktuale është angazhuar në menaxhimin dhe monitorimin e zonave të mbrojtura në qarkun Lezhë.